



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GJERGJ R. KONGOLI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA
NR. 3
TEL: 0682033057

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3784

Nr. koleksioni: 1489

Tirane më 12/08/2021

Ligjet referuese:


- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021053630162262581

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 3789 REP
NR. 1489 KOL



KONTRATË SHITBLERJE
KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 12.08.2021 (dymijë e njëzet e një), para meje noterit publik, Gjergj Kongoli, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në Tiranë paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë “ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB” SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse:

Z. Arti Malaj, Arti Malaj, atësia Nik, amësia Drande, shtetas Shqiptar, lindur në Ivanaj, Shkodër dhe banues në MALËSI E MADHE, me adresë Haxhaj 03670026; Nd. 19; H. 1; Kastrat; Ivanaj; BAJZE; 4306; Malësi E Madhe, lindur më 10/06/1975, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032321136 dhe nr. personal H50610046S, i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB” SHPK.

Dhënëse Pëlqimi:

Znj. Kimberley MALAJ, shtetase amerikane, e datëlindjes 17.03.1982, lindur në SHBA dhe banuese në Tiranë, në adresën Rruga Haxhaj, BAJZE MALESI E MADHE (sipas deklarimit të saj), madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës nr.563290104, e cila paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e bashkëshortes së z. Arti Malaj dhe për rrjedhojë bashkëpronare, për efekt martese, në kuotën që z. Malaj zotëron në shoqërinë “ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB” SHPK

Pala Blerëse:

Z. Eduard Curraj, atësia Gjon, amësia Shaqe, shtetas Shqiptar, lindur në Jeran, Shkodër dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Ndrecaj; Nd. 001; Kastrat; Bajzë; 4306; Malësi E Madhe, lindur më 13/10/1973, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033871246 dhe nr. personal H31013028R, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit (ID) me numër personal H3101328R

Kushtet Paraprake

- Shoqëria “ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB” SHPK, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) L91329021O, me zyrë qendrore në Tiranë, Rruga Murat Toptani, Kalaja e Tiranës; me kapital të regjistruar 100,000 (njëqind mijë) lekë; me ortak të vetëm z. Arti Malaj, zotërues



P1 (një) kuote, e cila përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë; me administrator z. Elis Malaj;
Pala shitëse është e interesuar të shesë kuotën që ai zotëron në shoqërisë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Arti Malaj, i shet palës blerëse Eduard Curraj, kuotën që zotëron në shoqërinë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK dhe e cila përbën 100% të kapitalit të regjistruar të kësaj shoqërie.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, ortak i vetëm i shoqërisë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK do të jenë z. Eduard Curraj, zotëruar i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës, objekt i kësaj kontrate, është 100,000 (njëqind mijë) lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse direkt në llogarinë bankare të komunikuar nga pala shitëse Arti Malaj, brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

3.2 Për çdo vonesë në pagesën e çmimit, do të aplikohet një interes në masën 10% në vit.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar dhe teknik të shoqërisë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerjeje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe z. Eduard Curraj do të bëhet ortak i vetëm i shoqërisë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën që ai ka në shoqërinë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK.

VI. DHËNËSJA E PËLQIMIT

Dhënësja e pëlqimit Znj. Kimberley MALAJ, bashkëshorte e ortakut të vetëm Arti Malaj dhe bashkëpronare, për efekt martese, në kuotën që Z. Arti Malaj zotëron në shoqërinë "ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB" SHPK, deklaron se është dakord që kuota, objekt i kësaj kësaj kontrate, të shitet Z. Eduard Curraj dhe pas kësaj shitje palët të procedojnë lidhur me të gjitha ndryshimet e rëna dakord në këtë kontratë.

Dhënësja e pëlqimit Znj. Kimberley MALAJ, deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë shitje të kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me shitje apo me çdo vendimarrje tjetër që Z. Arti Malaj po ndërmerr në marrëdhënien tregtare me Z. Eduard Curraj.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një original regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një original e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE

ARTI MALAJ

Arti Malaj

DHËNËSE E PËLQIMIT

KIMBERLEY MALAJ

Kimberley Malaj KM

PALA BLERËSE

EDUARD CURRAJ

Eduard Curraj

Curraj

NOTER

**NOTER
GJERGJ KONGOLI**



[Handwritten signature of Gjergj Kongoli]